



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 gusht 2016
Nr. ref.: RK974/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI11/16

Parashtrues

Aziz Rexhepi

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së
Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës
Supreme të Kosovës për Çështje në Lidhje me Agjencinë e
Privatizimit, AC-I-14-0311-A0001-A0023,
të 15 korrikut 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga z. Aziz Rexhepi nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktgjykimin e Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për Çështje në Lidhje me Agjencinë e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Apelit), AC-I-14-0311-A0001-A0023, të 15 korrikut 2015, i cili i ishte dorëzuar atij më 2 tetor 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Kolegjit të Apelit, me të cilin pretendohet të jenë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës sipas nenit 24 [Barazia para Ligjit], nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenit 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike] dhe nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 15 janar 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 shkurt 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Čukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
7. Më 27 prill 2016, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës dhe Kolegjin e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
8. Më 13 qershor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Parashtruesi i kërkesës pohon se ai ishte punonjës i Ndërmarrjes Shoqërore “Urata/Voçar” (në tekstin e mëtejme: “Urata/Voçar”), ku *“ka punuar nga viti 1974 deri në vitin 1992 dhe “nga viti 1992 deri në vitin 1999 ai ishte në marrëdhënie kontraktuale me ndërmarrjen, nga e cila ai ka pasur lokale afariste në shfrytëzim”*.
10. Më 20 maj 2007, ishte privatizuar “Urata/Voçar”.
11. Në një datë të pacaktuar, Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: AKP-ja), publikoi listën e përkohshme të punëtorëve me të drejtë në

20% të të ardhurave nga privatizimi i “Urata/Voçar” (në tekstin e mëtejshëm: të drejtë në 20%). Parashtruesi i kërkesës nuk është përfshirë në listë.

12. Më 21 korrik 2011, AKP-ja publikoi listën përfundimtare të punëtorëve që kanë të drejtë në 20%. Parashtruesi i kërkesës nuk ishte përfshirë as në atë listë.
13. Më 8 gusht 2011, parashtruesi parashtroi ankesë në Kolegjin e Specializuar të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme për Çështje në Lidhje me Agjencinë e Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm: Kolegji i Specializuar), duke pretenduar se *“vendimi i AKP-së ishte i padrejtë sepse bazohet në vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike, aplikimin e gabuar të së drejtës materiale, dhe kjo është arsyeja se pse atij i është mohuar e drejta në 20%”*. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon se *“ai është viktimë e diskriminimit”*.
14. Më 14 shtator 2011, AKP-ja iu përgjigj ankesës së parashtruesit, duke pretenduar se *“lista e përkohshme ishte botuar me një shënim që të punësuarit kanë të drejtë që brenda 20 ditësh të parashtrojnë ankesë kundër listës së përkohshme. Puditësi nuk e ka bërë këtë, dhe, për këtë arsye, AKP-ja ka propozuar që ankesa e parashtruesit të refuzohet si e papranueshme, për shkak se ai nuk i plotëson kriteret ligjore për marrjen e 20% në bazë të nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13”*.
15. Më 29 shtator 2014, Kolegji i Specializuar në Aktgjykimin e tij SCEL- 11-0045 e aprovoi si të bazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës, duke shpjeguar se *“ankuesi i referohet diskriminimit, dhe ai paraqiti fakte, nga të cilat mund të supozohet diskriminimi direkt ose indirekt. Gjykata konsideron se ankesa është e bazuar”*.
16. Më 28 tetor 2014, AKP-ja parashtroi ankesë në Kolegjin e Apelit.
17. Më 15 korrik 2015, Kolegji i Apelit në Aktgjykimin e tij AC-I-14-0311-A0001-A0023 e anuloi Aktgjykimin [SCEL-11-0045] e Kolegjit të Specializuar. Në arsyetim të aktgjykimit thuhet:

“Pasi që parashtruesi i kërkesës pretendon se largimi i tij nga puna ka ndodhur për shkak të diskriminimit etnik nga organet e dhunshme në NSH, duke mos dëshmuar me asgjë se kur dhe deri kur ka punuar në këtë NSH. Për këtë arsye, Kolegji i Apelit konstaton se ky ankues nuk i plotëson kriteret ligjore për t’u përfshirë në listën përfundimtare”.

Ligji relevant

18. Neni 10.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 mbi Transformimin e së Drejtës për Përdorimin e Pronës së Patundshme në Pronësi Shoqërore parasheh:

“Sipas këtij neni, punëtori konsiderohet si legjitim nëse është i regjistruar si punëtor i ndërmarrjes në pronësi shoqërore në kohën e privatizimit dhe nëse konstatohet se ka qenë në listën e pagave të ndërmarrjes për jo më pak se tri (3) vite. Kjo kërkesë nuk i ndalon punëtorët, të cilët pretendojnë se edhe ata do të ishin regjistruar apo punësuar, nëse nuk do të kishin

qënë diskriminuar, që të paraqesin ankesë në Dhomën e Posaçme, në pajtim me paragrafin 10.6”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtat dhe liritë e tij të garantuara me nenet 24 [Barazia para Ligjit], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 41 [E Drejta e Qasjes në Dokumente Publike] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejta të Njeriut] të Kushtetutës.
20. Parashtruesi i kërkesës pretendoi në Kolegjin e Specializuar se ai ishte *“viktimë e diskriminimit”*.
21. Parashtruesi kërkon që *“që të shqyrtohen mirë vendimi i AKP-së dhe vendimet e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme, të vlerësohet përputhshmëria e tyre me Kushtetutën dhe evidentohen shkeljet e dispozitave të lartpërmendura, si dhe të evidentohet diskriminimi, pra trajtimi i pabarabartë, që më është bërë nga ana e AKP-së, me rastin e nxjerrjes së listës përfundimtare për 20% dhe realizimin e kompensimit me rastin e privatizimit të NSH-së në Prishtinë”*.
22. Parashtruesi kërkon nga Gjykata që *“të anulohet Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit dhe të urdhërohen autoritetet kompetente që ta përfshijnë atë në listën e punëtorëve me të drejtë në 20% nga privatizimi”*.

Pranueshmëria e kërkesës

23. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
24. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafit 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

25. Përveç kësaj, Gjykata i referohet nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

26. Gjykata, gjithashtu, i referohet rregullit 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, i cili parasheh:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(d) *kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar*".

(2) *"Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:*

[...]

(b) *faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese*".

27. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të të drejtave të tij për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për qasje në dokumente publike.
28. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës për barazi para ligjit, Gjykata vëren se parashtruesi argumentoi se ai ishte diskriminuar *"sepse ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë nga AKP-ja në raport me punonjësit tjerë"*. Megjithatë, ai nuk ka shpjeguar pse dhe si ai është trajtuar në mënyrë të pabarabartë nga AKP-ja apo nga autoritetet tjera kompetente në raport me punëtorët tjerë. Prandaj, Gjykata konstaton se pretendimi është i pabazuar.
29. Në të vërtetë, Gjykata konsideron se procedurat dhe vendimet e AKP-së dhe të Kolegjit të Apelit nuk ishin rezultat i diskriminimit në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal, siç parashihet me nenin 24.2 të Kushtetutës. Parashtruesi ka pasur qasje të barabartë në AKP dhe mbrojtje të barabartë të të drejtave të tij para Kolegjit të Apelit.
30. Për më tepër, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka dëshmuar para Kolegjit të Apelit statusin e punësimit që kishte në NSH. Prandaj, Kolegji i Apelit nuk ka mundur të merret edhe me çështjen e diskriminimit, pasi parashtruesi i kërkesës nuk ishte punonjës *"që konsiderohet me të drejtë në 20% të të ardhurave"*, sipas nenit 10.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13.
31. Gjykata i referohet edhe praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ), e cila thekson se *"diskriminimi do të thotë trajtim ndryshe, pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, të personave në situata të ngjashme"* (Shih Aktgjykimin: *Willis kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 36042/97, paragrafi 48, GJEDNJ, 2002-IV, Aktgjykimi: *Bekos dhe Koutropoulos kundër Greqisë*, paragrafi 63, Aktgjykimi: *D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, paragrafi 44.)".
32. Në lidhje me shkeljen e pretenduar të së drejtës së parashtruesit të kërkesës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, Gjykata vëren se AKP-ja dhe gjykatat e rregullta ishin marrë me pretendimet e parashtruesit të kërkesës, si dhe me meritat e kërkesës së tij për ushtrimin e të drejtave që rrjedhin nga Rregullorja e UNMIK-ut 2003/13. Kolegji i Apelit konstatoi se *"parashtruesi i kërkesës nuk ka prezantuar asnjë dëshmi që tregon për marrëdhënien e tij të punës në këtë NSH"*. Kështu, ai konkludoi se *"ky ankues nuk i plotëson kriteret ligjore për t'u përfshirë në listën përfundimtare"*.

33. Gjkata konsideron se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit mori parasysh bazat e ankesës së parashtruesit dhe në mënyrë të qartë dhe koncize shpjegoi se pse ai nuk mund të përfshihej në listën e punëtorëve me të drejtë në 20% të të ardhurave nga privatizimi i Urata/Voçar.
34. Rrjedhimisht, Gjkata konsideron se Kolegji i Apelit veproi në pajtim me të drejtën për gjykim të drejtë në bazë të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
35. Ai konstatim është në pajtim me praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, sipas së cilës gjykatat *“kanë obligim që t'i arsyetojnë vendimet e tyre në atë mënyrë që të paraqesin arsye të qarta dhe të kuptueshme në të cilat i kishin bazuar ato vendime”*. (Shih, GEDNJ, *Suominen kundër Finlandës*, nr. 37801, Aktgjykim i 1 korrikut 2003).
36. Gjkata, thekson më tej, se parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit ka shkelur të drejtën e tij për qasje në dokumente publike. Megjithatë, parashtruesi i kërkesës nuk ka deklaruar se në cilat dokumente publike ai nuk mund të kishte qasje dhe cili autoritet ia mohoi atij qasjen në mënyrë arbitrare. Prandaj, Gjkata nuk mund të gjejë ndonjë shkelje të të drejtës së parashtruesit të kërkesës për qasje në dokumente publike të garantuara me nenin 41 të Kushtetutës.
37. Si përmbledhje, Gjkata vlerëson se në procedurën e mbajtur nuk ka fakte apo rrethana në Gjykatën e Apelit që në çfarëdo mënyre do të tregonin se parashtruesit të kërkesës i është shkelur e drejta kushtetuese për barazi para ligjit, për gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe për qasje në dokumente publike.
38. Gjkata, më tej, konsideron se parashtruesi i kërkesës nuk i ka mbështetur pretendimet e tij dhe as nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me Kushtetutë dhe Konventën Evropiane për të Drejta të Njeriut (Shih rastin nr. KI19/14 dhe KI21/14, parashtrues: *Tafil Qorri dhe Mehdi Syla*, Gjkata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA. nr. 2129/2013, të 5 dhjetorit 2013 dhe Aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, CA nr. 1947/2013 të 5 dhjetorit 2013).
39. Gjkata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë siç përcaktohet me Kushtetutë, parashihet me Ligj dhe me Rregulloren e punës.
40. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenit 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) të Rregullores së punës, më 13 qershor 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T' UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Almiro Rodrigues



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Artë Rama-Hajrizi